

REPUBLICA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT TIRANË  
Nr. 5743 VENDIMIT.

5143

V E N D I M

" PËR REGJISTRIM TË PERSONIT JURIDIK "

Set, më datë \_\_\_\_\_ 6.1994 në Gjykatën e Rrethit Tiranë unë gjyqtarja e kësaj gjykate pasi shqyrtova materjalin e paraqitur nga VASILLAQ NASTO, VLADIMIR NASTO dhe ZAIM DADAJ për regjistrimin e shoqërisë si person juridik:

K O N S T A T O V A

Se, kërkesa e tyre për të regjistruar shoqërinë si person juridik të emërtuar " ARGJIRO BUIDING" sh.p.k. të themeluar nga ortakët Vasillaq Nasto, Vladimir Nasto dhe Zaim Dadaj në aktivitetin e tyre në ndërtim civil, industriale, turistike, buqësore etj, në restaurime të objekteve të ndryshme, predhime të materjaleve ndërtimore, tregtimin e materjaleve ndërtimore. Shoqëria ka selinë e saj në qytetin e Gjirokastrës në lagjen " Puntori " pll. 1 ap. 1 me një aktivitet mbi dhjetë vjet, me një kapital 100.000lek në natyrë të ndarë 45% Vasillaqi, 19% Vladimiri dhe 36%Zaimi, me Administrator të përgjithshëm ortakun Vasillaq Nasto. Kërkesa e tyre është e drejtë dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të ligjës 7638 datë 19.11.1992" Për Shoqëritë Tregtare ".

V E N D O S A

Regjistrimin e Shoqërisë " ARGJIRO BUIDING" sh.p.k. si person juridik të themeluar nga ortakët VASILLAQ NASTO, VLADIMIR NASTO dhe ZAIM DADAJ, në aktivitetin e tyre në ndërtimin e objekteve civile industriale, turistike, buqësore , etj, në rikestruksionin e objekteve të ndryshme, predhime të materjaleve ndërtimore, tregtimin e tyre. Shoqëria ka selinë e saj në qytetin e Gjirokastrës, në lagjen " PUNTORI" pll. 1 ap. 15, një aktivitet mbi dhjetë vjet me një kapital 100.000lek në natyrë, i ndarë në masën 45% Vasillaqi, 19% Vladimiri dhe 36% Zaimi, me Administrator të përgjithshëm të Sho-

-qërisë VASILLAQ NASTO.

Kuadra këtij vendimi lejohet ankim.

GJYQTARE

ANILA CAPO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT TIRANË  
Nr. 5143/1 VEN DIMIT

V E N D I M

( I gjyqtarit të vetëm )

Sot, më datë 22.03.1995, unë Gjyqtarja e kësaj Gjykate shqyrtova kërkesën e Z. VASILLAQ NASTO, Administrator i vetëm i Shoqërisë " ARGJIRO BUIDING " sh.p.k. Gjirokastër për depozitimin e dokumentave të kësaj shoqërie dhe:

K O N S T A T O V A

Se, me vendimin Nr. 5143 datë 28.6.1994 të Gjykatës së Rrethit Tiranë është regjistruar si person juridik Shoqëria " ARGJIRO BUIDING " sh.p.k.

Me vendim të Asambles së ortakve Nr. 1 datë 6.03.1995 të Noteruar në Noterin e Gjirokastrës është vendosur largimi i ortakut Zaim Dadaj, kalimi i kuotave të tij, 36% me shitje ortakut Vasillaq Nastro duke ju bërë kotat në masën 81%. Për këtë është bërë kërkesë dhe nga Administratori i Shoqërisë.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të Ligjës 7667 datë 28.I.1993

V E N D O S A

Pranimin e dokumentacioneve të Shoqërisë " ARGJIRO BUIDING " sh.p.k. me Administrator të vetëm Z. VASILLAQ NASTRO, për të depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë dokumentat si dhe duke bërë shënimet përkatëse në Regjistrin Tregtar, të largim nga shoqëria të ortakut Zaim Dadaj, kalimin e kuotave të tij me shitje ortakut Vasillaq Nastro, duke ju bërë këtij të fundit 81% .



GJYTARE

*Marijona Deol*  
*M. Deol*

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA E SHKALLES SE PARE**  
**Nr 5143/2**

**VENDIM**  
**I GJYQTARES SE VETME**

Sot me dt./10/2005 une gjyqtare e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Z.Vasillaq Nasto per depozitim e vendimit nr.2 dt.15.06.2005 te asamblese se ortakeve te shoqerise tregtare "ARGJIRO-BUILDING" shpk dhe :

**KONSTATOVA**

Me vendimin nr.5143 dt.28.06.1994 eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregtare "ARGJIRO-BUILDING" shpk me administrator Z.Vasillaq Nasto me seli ne Gjirokaster, me kapital fillestar 100.000 lek me kohezgjatje mbi 10 vjet.

Me vendimin nr.2 dt.15.06.2005 eshte vendosur :

-Te caktoje eksperten kontabel te autorizuar Znj.Stoli Laze per shtesen e kapitalit te shoqerise.

-Depozitim e ketij ndryshimi ne Zyren e regjistrit Tregtar te Gjykates Tirane.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

**PER KETO ARSYE**

Ne baze te ligjit nr.7512 dt.10.08.1991, ligjit nr.7638 dt.19.11.1992 ligjit nr.7667 dt.28.01.1993 " Per regjistrin tregtar".

**VENDOSA**


-Pranimin e kerkeses.

-Depozitim ne rregjistrin tregtar te vendimit nr.2 dt.15.06.2005 te administratorit te shoqerise tregtare « ARGJIRO-BUILDING»shpk.

-Te ndahen regjistrimet nga njeri-tjetri me vije te kuqe dhe te behen ndryshimet perkatese ne kolonat 4 dhe 5.


-Kunder vendimit lejohet ankim.

**GJYQTARE**



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE**  
NR. 5143/3 **VENDIMIT**

**VENDIM**  
**I GJYQTARIT TE VETEM**

Ne Tirane , sot me date 27/10 2005 , une   
Gjyqtare e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane , mora ne shqyrtim kerkesen  
e paraqitur nga kerkuesi Vasillaq Nasto, per depozitimin ne regjistrin  
tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane ,te vendimit nr. 03 date  
20/10/2005 te asamblese se ortakeve te shoqerise me pergjegjesi te  
kufizuar " ARGJIRO- BUILDING " sh.p.k. :

**KONSTATOVA SE**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "ARGJIRO-BUILDING " sh.p.k.  
eshte regjistruar ne Gjykaten e Shkalles se pare Tirane me vendimin nr.  
5143 date 28.06.1994 dhe aktualisht eshte e perbere nga ortaket  
Vasillaq Nasto dhe Vladimir Nasto qe zoterojne teresisht 100% te pjeseve te  
kapitalit themeltar te shoqerise ne raportet 81% nga Vasillaq Nasto dhe 19%  
nga Vladimir Nasto.

Kjo shoqeri eshte regjistruar dhe figuron me kapital themeltar ne  
vleren 100 000 ( njeqind mije) leke, kapital i depozituar teresisht nga  
kontributet e ortakeve ne raportet 81% me 19% te pjeseve te kapitalit te  
shoqerise .

Nga analiza e vitit financiar 2004, rezultojne te kete shtesa te kapitalit  
te shoqerise ,dhe keto rrethana me vendimin nr. 2 date 15 qershor 2005  
asambleja e ortakeve te kesaj shoqerie ka vendosur : Fitimi neto i mbartur  
per periudhen 1994-2004 te mos u shperndahet ortakve dhe Ky fitim te  
perdoret per zmadhimin e kapitalit te shoqerise, caktohet eksperti kontabel i  
autorizuar znj. Stoli Laze per te kryer dhe paraqitur raportin e vleresimit te  
gjendjes se kapitalit te shoqerise per efekt te zmadhimit te kapitalit.

Ky vendim eshte depozituar ne regjistrin tregetar te Gjykates se  
Shkalles se Pare Tirane dhe ne baze te ketij vendimi eksperti kontabel i  
autorizuar znj. Stoli Laze ka kryer dhe paraqitur raportin e vleresimit te  
gjendjes se kapitalit te shoqerise .

Ne baze te ketij raporti asambleja e ortakeve me vendimin nr. 03 date  
20-10-2005 ka vendosur:

5. Miratimin e raportit te vleresimit te paraqitur nga eksperti kontabel i  
autorizuar znj. Stoli Laze.
6. Zmadhimin e kapitalit themelatr te shoqerise " Argjiro Building "  
sh.p.k. nga vlera 100 000 ( njeqind mije ) leke ne vleren 5 300 000  
( pese milion e treqind mije ) leke.
7. Pasqyrimin e ndryshimeve ne statutin dhe aktin e themelimit te  
shoqerise.
8. Depozitimin e ketij vendimi ne zyren e regjistrit tregetar te Gjykates se  
Shkalles se Pare Tirane.
- 1.

Per sa me siper , kerkesa eshte e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet  
pranuar.

PER KETO ARSYE

Bazuar ne ligjin nr. 7667 date 28.1.1993 dhe ne ligjin nr.7638 date 19.11.1992:

VENDOSA

Pranimin e kerkeses.

- Depozitimin ne regjistrin tregetar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane , te vendimit nr. 03 date 20/10/2005 te asamblese se ortakeve te shoqerise "ARGJIRO-BUILDING " SH.P.K.  
Te behen ndryshimet perkatese ne kolonen perkatese te regjistrin tregetar

**GJYQTARE**

A handwritten signature in black ink, written in a cursive style, positioned below the printed word 'GJYQTARE'. The signature is written over a horizontal line.

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE  
Nrr. 5143/4 VENDIMI

V E N D I M  
I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane, sot me date 17-02-2006, une J. Hoxha Gjyqtare e  
Gjykates Rrethit Gjyqesor Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesit  
Vasillaq Nasto, administratori i Shoqeris Me Pergjegjesi te Kufizuar "ARGJIRO -  
BULDING", Sh.P.K. Gjirokaster, per depozitimin ne regjistrin tregtar te kesaj Gjykate  
Te d vendimit nr .4 te asambles se ortakeve te shoqerise,

K O N S T A T O V A S E

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "ARGJIRO - BULDING" Sh.P.K. eshte  
regjistruar ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane me vendimin nr.5143 dates 28.06.1994  
dhe aktualisht eshte me ortaket Vasillaq Nasto, administrator, si dhe Vladimir Nasto .

Per te vazhduar aktivitetin e saj kjo shoqeri ,ne vendimin nr.4 te asambles se ortakeve te  
shoqeris "Argjiro Buiding" Sh.P.K. Gjirokaster eshte vendosur zgjatja e afatit kohor nga  
ajo e percaktuar ne akt themelimin e shoqerise, ne shtesen e afatit kohor te ushtrimit te  
aktivitetit te saj, ne 10 vjet te tjera.

Administatri i shoqeris ka paraqite kerkesen per depozitimin e vendimit nr. 4 te asambles  
se ortakeve te shoqerise "Argjiro Buiding".

Kerkesa eshte e bazuar ne ligj dhe si e tille ka vend qe te pranohet .

P E R K E T O A R S Y E

Bazuar ne ligjin nr.7667 dates 28.1.1993, si dhe ne ligjin nr.7638 dates 19.11.1992

V E N D O S A

Pranimin e kerkeses.

Depozotimin ne regjistrin tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, te vendimit nr.4  
te samblese se ortakeve te shoqerise ,, ARGJIRO - BULDING" Sh.P.K. Gjirokaster.  
Te behen ndryshimet perkatese ne kolonn perkatese te regjistrin tregtar .

GJYQTARE  
J. Hoxha  
[Signature]



## STATUTI I SHOQERISE

### KREU I

#### EMERTIMI, SELIA, KOHE ZGJATJA DHE AKTIVITETI

##### NENI 1

Shoqëria emërtohet "ARGJIRO BUIDING" sh.p.k EKSPORT-IMPORT  
Ajo është person juridik dhe zhvillon aktivitetin e saj në  
përputhje me aktin e themelimit në këtë statut dhe gjithmonë në  
zbatim të legjislacionit shqiptar.

##### NENI 2

Shoqëria e ka selinë e saj në Gjirokastër, Lagjia  
"Punëtori", Pll.1, Ap.15.

##### NENI 3

Kohë zgjatja e shoqërisë është mbi dhjetë vjet dhe mund të  
shpërbëhet në çdo kohë me vendim të Asamblesë së ortakve.

##### NENI 4

Shoqëria ka për objekt të saj:

- Ndertime civile, industriale, turistike, bujqësore etj;
- Restaurime të objekteve të ndryshme;
- Prodhime të materjaleve ndërtimore;
- Tregtimin e materjaleve ndërtimore.

Si dhe çdo aktivitet tjetër, që veças ose së bashku me ato  
të përmendura mësipër do të konsiderohen të përshtatshme dhe me  
leverdi për rritjen e zhvillimin e firmës.

#### KAPITALI THEMELOR

### KREU II

##### NENI 5

Kapitali fillestar i shoqërisë është 100 000 lek në natyrë  
i ndarë në kuotat në 45 %, 19% dhe 36 % secili dhe merret  
përsipër dhe nënshkruhet si më poshtë:

1. VASILLAQ NASTO

45%

ADIMIR NASTO

19%





#### NENI 6

Kuotat e kapitalit mund të shiten midis ortakve, sipas vlerës së përgjithshme të realizuar deri në atë moment nga shoqëria.

Ofertat bëhen në përputhje me kuotat e poseduara nga çdo ortak dhe ju bëhet e njohur me shkrim ortakve që janë të regjistruar në librin e ortakve, duke lënë një kohë maksimale prej 50 ditësh për të vendosur.

Me të skaduar ky afat, ortaku shitës ka të drejtë të shesë kuotën e të tretëve gjithmonë me aprovimin paraprak të Asamblesë të ortakve. Në çdo rast, ortaku shitës ka të drejtë në shoqëri t'i nënshtrohet miratimit paraprak të Asamblesë, e cila ka një kohë në dispozicion prej 30 ditësh për tu shprehur dhe në rast mospërgjigje brenda këtij afati, miratimi quhet i dhënë.

Kuotat e kapitalit, në rast vdekje i kalohen trashëgimtarëve, duke hyrë këta të fundit në të gjitha të drejtat e ortakut.

#### NENI 7

Shoqëria është pronare e mjeteve të saj.  
Ajo ka të drejtë të përdorë e të disponojë mjetet e saj në përputhje me ligjet shqiptare.

#### NENI 8

Adresa e ortakve, përsa i përket marrëdhënieve të tyre me shoqërinë është ajo e realizuar në librin e ortakve.

### KREU III ASAMBLEA E ORTAKVE

#### NENI 9

Asambleja, ligjërisht e thirrur nëpërmjet, fax, telex, telegramit apo me letër rekomande dhe rregullisht e themeluar përfaqëson interesin e ortakve dhe është organi sovran i shoqërisë. Thirrja duhet të bëhet jo më pak se dhjetë ditë përpara asaj të caktuar për mbledhje.

Vendimet e saj të marra konformë ligjit dhe këtij statuti janë të detyrueshme për të gjithë ortakët, përfshi edhe ata në



#### NENI 10

Asamblea është e zakonshme dhe e jashtëzakonshme.

Ajo mbledhet në formën e jashtëzakonshme për:

- a/ për të bërë ndryshime në statutin e shoqërisë.
- b/ për të vendosur rritjen apo uljen në kapitalin e shoqërisë.
- c/ për të kaluar në likuidimin e parakohshëm të shoqërisë ose për të zgjatur afatin.

#### NENI 11

Asambletë vendosin në mënyrë të vlefshme me votën pro të shumicës të kapitalit të shoqërisë.

#### NENI 12

Asambletë thirren nga Administratori i vetëm i precizuar në rendin e ditës dhe argumentet që do të trajtohen, në selinë e shoqërisë apo në vend tjetër në Shqipëri dhe jashtë saj, ashtu siç do të përmendet në njoftimin e thirrjes. Asambleja do të jetë rregullisht e mbledhur edhe në mungesë të formaliteteve më lart sa herë që të jetë prezent i tërë kapitali i shoqërisë si dhe organi Administrativ i saj.

#### NENI 13

Asamblea e zakonshme duhet të thirret të paktën njëherë në vit, brënda tre muajve nga mbyllja e periudhës ushtrimore. Asamblea e jashtëzakonshme mbledhet për vendimet e kompetencës së saj sa herë që organi administrativ ta quaj të arësyeshme.

#### NENI 14

Kanë të drejtë të marrin pjesë në Asambleenë e ortakëve vetëm ortakët që figurojnë në librin e ortakëve.

Ortakët mund të përfaqësohen nga një ortak tjetër nëpërmjet një prokure të thjeshtë me shkrim.

#### NENI 15

Administratortë thirret nga një administrator i vetëm i



mëpas nga asambleja e ortakve. Administratori i vetëm qëndron në detyrë tre vjetë dhe është i rizgjedhshëm. Administratori i vetëm mund të emëroj administrator të deleguar apo të ngarkuar për veprime të ndryshme duke përcaktuar edhe fuqitë e tyre.

#### NENI 16

E drejta e firmës dhe e përfaqësimit të shoqërisë i takon Administratorit të vetëm.

#### NENI 17

Për të kontrolluar veprimtarinë ekonomike financiare të shoqërisë, asambleja e ortakve mund të emëroj një këshill revizorësh të përbërë nga tre anëtarë duke përcaktuar fuqitë dhe shpërblimin e tyre.

### KREU IV

#### BILANCI I SHOQËRISE

#### NENI 18

Periodhat ushtrimore mbyllen më 31 dhjetor të çdo viti. Në fund të çdo viti të çdo periudhe ushtrimore Administratori i vetëm duhet të përgatisi bilancin sipas afatave e mënyrës së përcaktuar në ligj i shoqëruar edhe me një relacion mbi ecurinë e shoqërisë.

#### NENI 19

Fitimi neto që do të rezultojë nga bilanci i shoqërisë do të ndahet sipas mënyrës së mëposhtëme:  
- 5% do të veçohet për tu përdorur si fond rezerv, përdorimi i pjesës tjetër do tu përkasi ortakve, me përjashtim të një vendimi tjetër të asamblesë së ortakve.  
Ortakët marrin pjesë në ndarjen e fimit në proporcion me pjesmarrjen e tyre në kapitalin e shoqërisë.  
Ortakët mbeten përgjegjës për detyrimet e shoqërisë në proporcion me kapitalin e marrë përsipër.



KREU V

SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI

NENI 20

Aktiviteti i shoqërisë mer fund nga bilancet kontabël rezulton se ajo është kontabël apo kur ortakët tërhiqen nga shoqëria sipas parashikimit të bërë në aktin e themelimit ose kur mbaron afati i kohë zgjatjes së shoqërisë

NENI 21

Duke arritur në shpërndarjen e shoqërisë, Asambleja e ortakve vendos në përputhje me ligjin, emërimin e një ose dy likuidatorëve duke përcaktuar kompetencat dhe shpërblimet.

NENI 22

Cdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis ortakve do të zgjidhet sipas pikës 9 të aktit të themelimit

NENI 23

Ky akt u redaktua në katër ekzemplarë duke patur të njëjtën vlerë ligjore.

ORTAKET

VASILLAG NASTO  
VLADIMIR NASTO  
ZAIM DADAJ

*Vasillag Nasto*  
*Zaim Dada*

AVOKAT



AKTI I THEMELIT TE SHOQERISE

ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

Sot, më datën 21.VI.1994, këtu në Tiranë përpara meje Avokates Luljeta Kongoli u paraqitën personalisht subjektet e mëposhtme:

1. VASILLAQ NASTO, i biri i Thomait, lindur në 1956, banues në Gjirokastër.
2. VLADIMIR NASTO, i biri i Thomait, lindur në 1964, banues në Gjirokastër.
3. ZAIM DADAJ, i biri Muhametit, lindur në 1961, banues në Gjirokastër.

NENI 1

Midis subjekteve të mësipërm themelohet një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e quajtur "ARGJIRO BUIDING" SH.P.K. EKSPORT-IMPORT

NENI 2

Shoqëria e ka selinë e saj legale në Gjirokastër, Lagjia "Punëtori", Pll. 1, Ap.15.

NENI 3

Kohëzgjatja e shoqërisë është mbi dhjetë vjet dhe mund të shpërbëhet në çdo kohë.

NENI 4

Shoqëria ka për objekt të aktivitet të saj:

- Ndertime civile, industriale, turistike, bujqësore etj;
- Restaurime të objekteve të ndryshme;
- Prodhime të materjaleve ndërtimore;
- Tregtimin e materjaleve ndërtimore.

Si dhe çdo aktivitet tjetër, që veças ose së bashku me ato të përmendura mësipër do të konsiderohen të përshtatshme dhe me leverdi për rritjen e zhvillimin e firmës.



#### NENI 5

Kapitali i shoqërisë është 100 000 lekë i ndarë në kuotat 45%, 19% dhe 36% sejcili dhe merret përsipër dhe nënshkruhet si më poshtë:

- |                   |     |
|-------------------|-----|
| 1. VASILLAQ NASTO | 45% |
| 2. VLADIMIR NASTO | 19% |
| 3. ZAIM DADAJ     | 36% |

Kapitali duhet të derdhet plotësisht pranë një banke apo të jetë i depozituar pranë një noteri. Po kështu dhe për kapitalin në natyrë.

#### NENI 6

Shoqëria do të administrohet nga një Administrator i vetëm. Administratori i vetëm emërohet VASILLAQ NASTO, që pranon detyrën, duke autorizuar në mungesë të tij Zotin VLADIMIR NASTO dhe ZAIM DADAJ që të kryejnë në këtë akt dhe në statutin e bashkëlidhur të gjitha ndryshimet, modifikimet apo të heqin çdo gjë që eventualisht do t'i kërkohet me rastin e regjistrimit të shoqërisë.

#### NENI 7

Palët do të kenë një pjesmarrje në fitimin e shoqërisë në masën e pjesmarrjes së tyre në kapitalin e shoqërisë. Palët mbeten gjithashtu përgjegjëse për detyrimet e shoqërisë në kufijtë e kapitalit të marrë përsipër.

#### NENI 8

Palët kanë të drejtë të heqin dorë nga shoqëria kur kanë motive të drejta për këtë, por duke paralajmëruar shoqërinë dy muaj përpara.

#### NENI 9

Cdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis ortakve do të zgjidhet miqësisht dhe në mungesë të një marrëveshjeje, instanca kompetente do të jetë Gjykata e Tiranës.

#### PALET

Zotërinjtë: VASILLAQ NASTO  
VLADIMIR NASTO  
ZAIM DADAJ

V E N D I M    N r . 4

ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE „ARGJIRO BUIDING”  
SH.PK. GJIROKASTER

Shoqeria “ARGJIRO BUIDING”SH.P.K. Gjirokaster eshte regjistruar prane Gjykates Rrethit Tiranes, me numer 5143 dates 28.06.1994 . ne te cilen jane kryer ndryshime te pasqyruar ne vendimet perkatese te kesaj gjykate,ne vendimet me nr.5143/1 te dates 22.03.1995,vendimin me nr. 5143/3 dates 27.10.2005.  
Asambleja e ortakeve te Shoqerise e mbledhur me date sot me date 03.02.2006,mori ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga administrator ii shoqerise Zoti Vasillaq Nasto per zgjatjen e afatit kohor te ushtrimit te aktivitetit te kesaj shoqerie. .  
Asambleja e shoqerise “Argjiro Buiding”Sh.P.K.Gjirokaster ,

V E N D O S I

1/ Zgjatjen e afati kohor te vazhdimit te aktivitetit te Shoqerise Me Pergjegjesi te Kufizuar , Sh.P.K.”Argjiro Buiding” Gjirokaster, mbi 10 vjet nga afati qe eshte perezaktuar ne aktthemelinmin e saj .  
Ky afat kohor kerkohet qe shoqeria te vazhdoj aktivitetin e saj ne vazhdimesi .pa ndeprerje.

ORTAKET E SHOQERISE

VASILLAQ NASTO dhe VLADIMIR NASTO

Vasillaq NASTO  
06

Vladimir NASTO  
NASTO

REPUBLIKA E SHQIPRISE  
DHOMA E NOTERIS TIRANE  
Nr. i rep. 352

VERTETIM NENSHKRIMI

Vertetoj se sot me date 06.02.2006(dymije e gjashte),paraqiten personalisht para meje Noteres te Dhomes se Noteris ne Tirane, Fato Korvafaj, me Zyre ne rrugen „Muhamet Gjollsha“ ortaket e Shoqerise Me Pergjegjesi te Kufizuar „SH..P.K.“Argjiro Buiding“ne Gjirokaster,si me poshte:

1/ Vasillaq Nasto, i biri Thomait ,dt.1956,me banim ne Gjirokaster ,me leter njoftimin e tij UG Nr. 285766,si dhe

2/ Vladimir Nasto, i biri Thomait ,dt.1964,me banim ne Gjirokaster ,

qe te dy madhor me zotesi te plote juridike sidhe per te vepruar,ata deklarojne se jane dakort me vendimin nr 2 te asamblese te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar , Sh.P.K. „Argjiro Buiding“Gjirokaster, per kohe zgjatjen e aktivitetit te saj .

Venimin e asamblese e kane nenshkruar me vullnetin e lire e te plote te tyre ,para meje Noteres si dhe une Noterja e siguar ne indentitetin e tyre e vertetoj ne baze te ligjit .



NOTERE

NOTERE  
FATO KORVAFAJ





nr 5143/4  
Datë 06.02.2006

Z. D. Hoxha  
09 SHKURT 2006

K Ë R K E S Ë

KËRKUESIT : VASILLAQ NASTO, i biri Thoma dhe i Eftiqis, dt. 1956, lindur në Gjirokastrë me banim po atje, madhor me zotësi të plotë juridike si dhe për të vepruar me letër njoftimin e tij UG Nr. 285766, administrator i Shoqëris me Përgjegjësi të Kufizuar "Argjiro Buiding" Gjirokastrë.

OBJEKTI : Kërkoj që të depozitohet vendimi nr. 4 të asamblesë të Sh.P.K. "Argjiro Buiding", për shtim të afatit kohor.

BAZA LIGJORE : Ligji me nr. 7667 datë 28.01.1993.

PËR KOMPETENCË

GJYKATËS RRETHIT GJYQËSOR

*Te Depozitimet  
Vendimi i Asamblesë nr  
TIRANË  
Ostatore nr 4 datë  
03.02.2006.*

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Argjiro Buiding" Gjirokastrë është e regjistruar pranë kësaj gjykate me vendimin nr. 5143 datë 28.6.1994, si person juridik.

Në bazë vendimit nr 4 të asambles të kesaj shoqerie vendose shtyrja e afatit kohor mbi 10 vjet nga ajo qe eshte caktuar ne fillim te krijimit te saj.

Nga kjo Gjykate kerkoj depozitim e vendimit nr. 4 te asamblese te Sh.P.K. "Argjiro Buiding" Gjirokastrë.

K ë r k u e s i

VASILLAQ NASTO

*Vasillaq NASTO*  
*[Signature]*

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERIS TIRANE  
Nr. i rep. 351

VERTETEM NESHKRIMI

Vertetoj se sot me date 06.02.2006(dymije e gjashte)dite e hene ,paraqitet personalisht para meje Noteres te Dhomes se Noteris ne Tirane, Fato Korvafaj , me seli ne Tirane ne rrugen "Muhamet Gjolllesha", adminstatori i Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar SH.P.K. "Vasillaq Nasto ,me banim ne Gjirokater, me leter njoftimin e tij me inicialet UG Nr. 285766.i cili eshte madhor me zotesi te plote juridike ,ai deklaroi se [eshte dakort me kerkesen e tij bashkengjitur ketj veretim nenshkrimi , si dhe une noterja e v[rtetoj n] baze te ligjit si u sigurova mbi indentitetin e tij .



NOTERE

NOTERE  
FATO KORVAFAJ



## VENDIM

### I asamblese se ortakeve te shoqerise

### “ARGJIRO-BULIDIND ” SH.P.K.



Ne Tirane sot me dt. 20/10/2005 , asambleja e ortakeve te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar “ARGJIRO- BULIDIND ” sh.p.k.me pjesemarrjen e te dy ortakeve , Vasillaq Nasto dhe Vladimir Nasto qe perbejne 100% te pjeseve te kapitalit te kesaj shoqerie :

### VEREN

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar shoqeria “ARGJIRO-BUILDING ” sh.p.k. eshte regjistruar ne Gjykatën e Shkalles se pare Tirane me vendimin nr. 5143 date 28.06.1994 dhe aktualisht eshte e perbere nga ortaket Vasillaq Nasto dhe Vladimir Nasto qe zoterojne teresisht 100% te pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise ne raportet 81% nga Vasillaq Nasto dhe 19% nga Vladimir Nasto.

Kjo shoqeri eshte regjistruar dhe figuron me kapital themeltar ne vleren 100 000 ( njeqind mije) leke, kapital i depozituar teresisht nga kontributet e ortakeve ne raportet 81% me 19% te pjeseve te kapitalit te shoqerise .

Nga analiza e vitit financiar 2004, rezultojne te kete shtesa te kapitalit te shoqerise ,dhe keto rrethana me vendimin nr. 2 date 15 qershor 2005 asambleja e ortakeve te kesaj shoqerie ka vendosur : Fitimi neto i mbartur per periudhen 1994-2004 te mos u shperndahet ortakve dhe Ky fitim te perdoret per zmadhimin e kapitalit te shoqerise, caktohet eksperti kontabel i autorizuar znj. Stoli Laze per te kryer dhe paraqitur raportin e vleresimit te gjendjes se kapitalit te shoqerise per efekt te zmadhimit te kapitalit.

Ky vendim eshte depozituar ne regjistrin tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane dhe ne baze te ketij vednimi eksperti kontabel i autorizuar znj. Stoli Laze ka kryer dhe paraqitur raportin e vleresimit te gjendjes se kapitalit te shoqerise .

Ne baze te ketij raporti asambleja e ortakeve :

### VENDOSI

1. Miratimin e raportit te vleresimit te paraqitur nga eksperti kontabel i autorizuar znj. Stoli Laze.
2. Zmadhimin e kapitalit themelatr te shoqerise “ Argjiro Building “ sh.p.k. nga vlere 100 000 ( njeqind mije ) leke ne vleren 5 300 000 ( pese milion e treqind mije ) leke.
3. Pasqyrimin e ndryshimeve ne statutin dhe aktin e themelimit te shoqerise.
4. Depozitimn e ketij vendimi ne zyren e regjistrit tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

PER SA ME SIPER ORTAKET RANE DAKORT DHE NENSHKRUAN

Vasillaq Nasto Vladimir Nasto

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE  
NOTERE SILVANA MERKO

NR. 824 Repertori

**VERTETIM**

Ne Tirane , sot me date 20-10-2005 , para meje noteres Silvana Merko, anetare e dhomes se noterise Tirane, me seli ne blv“ Gjergj Fishta” m'u paraqit personalisht Vasillaq Nasto , i biri i Thomait, lindur dhe banues ne Gjirokaster , identifikuar sipas ligjit, dhe Vladimir Nasto, i biri i Thomait, banues ne Gjirokaster, identifikuar sipas ligjit, te cilet deklaruan se sa me siper eshte nenshkruar prej tyre me vullnet te lire.

Une noterja si u binda per identitetin,vertetoj nenshkrimin per t'i dhene fuqi ligjore.

NOTERE  
SILVANA MERKO



5143/3

8 Blerime Muzaj  
26 10 2005  
Muzaj

**KERKESE**

26 TETOR 2005

**KERKUESI**

: Vasillaq Nasto , madhor, lindur dhe banues ne Gjirokaster.

**OBJEKTI**

: Depozitimi ne regjistrin tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane te vendimit nr. 03 date 20-10-2005 te asamblese se ortakeve te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " ARGJIRO-BUILDING " SH.P.K. ne baze te n. 243 te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregetare"

**PERPARA GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR TIRANE**

Ju parashtroj se shoqeria "ARGJIRO-BUILDING " sh.p.k. eshte regjistruar ne Gjykaten e Shkalles se pare Tirane me vendimin nr. 5143 date 28.06.1994 dhe aktualisht eshte e perbere nga ortaket Vasillaq Nasto dhe Vladimir Nasto qe zoterojne teresisht 100% te pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise ne raportet 81% nga Vasillaq Nasto dhe 19% nga Vladimir Nasto.

Kjo shoqeri eshte regjistruar dhe figuron me kapital themeltar ne vleren 100 000 ( njeqind mije) leke, kapital i depozituar teresisht nga kontributet e ortakeve ne raportet 81% me 19% te pjeseve te kapitalit te shoqerise .

Nga analiza e vitit financiar 2004, rezultojne te kete shtesa te kapitalit te shoqerise ,dhe keto rrethana me vendimin nr. 2 date 15 qershor 2005 asambleja e ortakeve te kesaj shoqerie ka vendosur : Fitimi neto i mbartur per pieriudhen 1994-2004 te mos u shperndahet ortakeve dhe ky fitim te perdoret per zmadhimin e kapitalit te shoqerise, caktohet eksperti kontabel i autorizuar znj. Stoli Laze per te kryer dhe paraqitur raportin e vleresimit te gjendjes se kapitalit te shoqerise per efekt te zmadhimit te kapitalit.

Ky vendim eshte depozituar ne regjistrin tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane dhe ne baze te ketij vendimi eksperti kontabel i autorizuar znj. Stoli Laze ka kryer dhe paraqitur raportin e vleresimit te gjendjes se kapitalit te shoqerise .

Ne baze te ketij raporti asambleja e ortakeve me vendimin nr. 03 date 20-10-2005 ka vendosur:

1. Miratimin e raportit te vleresimit te paraqitur nga eksperti kontabel i autorizuar znj. Stoli Laze.
2. Zmadhimin e kapitalit themelatr te shoqerise " Argjiro Building " sh.p.k. nga vlere 100 000 ( njeqind mije ) leke ne vlere 5 300 000 ( pese milion e treqind mije ) leke.
3. Pasqyrimin e ndryshimeve ne statutin dhe aktin e themelimit te shoqerise.
4. Depozitimin e ketij vendimi ne zyren e regjistrimit tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

ADMINISTRATOR  
Vasillaq Nasto

5143/2

3 Bler me Ancaj  
12 TETOR 17 10 2005

**KERKESE**

2005

**KERKUESI** : Vasillaq Nasto , madhor, lindur dhe banues ne Gjirokaster.

**OBJEKTI** : Depozitimi ne regjistrin tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane te vendimit nr. 02 date 15-06-2005 te asamblese se ortakeve te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " ARGJIRO-BUILDING " SH.P.K. ne baze te n. 243 te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregetare"

**PERPARA GJYKATES SE SHKALLES SE PARE TIRANE**

Ju parashtroj se shoqeria "ARGJIRO-BUILDING" sh.p.k. eshte regjistruar ne Gjykatën e Shkalles se pare Tirane me vendimin nr. 5143 date 28.06.1994 dhe aktualisht eshte e perbere nga ortakët Vasillaq Nasto dhe Vladimir Nasto qe zoterojne teresisht 100% te pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise ne raportet 81% nga Vasillaq Nasto dhe 19% nga Vladimir Nasto.

Kjo shoqeri eshte regjistruar dhe figuron me kapital themeltar ne vleren 100 000 ( njeqind mije) leke, kapital i depozituar teresisht nga kontributet e ortakeve ne raportet 81% me 19% te pjeseve te kapitalit te shoqerise .

Nga analiza e vitit financiar 2004, rezultojne te kete shitesa te kapitalit te shoqerise .

Ne keto rrethana me vendimin nr. 2 date 15 qershor 2005 asambleja e ortakeve te kesaj shoqerie ka vendosur :

1. Fitimi neto i mbartur per pieriudhen 1994-2004 te mos u shperndahet ortakve.
2. Ky fitim te perdoret per zmadhimin e kapitalit te shoqerise.
3. Caltohet eksperti kontabel i autorizuar znj. Stoli Laze per te kryer dhe paraqitur raportin e velresimit te gjendjes se kapitalit te shoqerise per efekt te zmadhimit te kapitalit.
4. Pasqyrimin e ndryshimeve ne statutin dhe aktin e themelimit te shoqerise.
5. Depozitimn e ketij vendimi ne zyren e regjistrin tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

ADMINISTRATOR  
Vasillaq Nasto

*(Signature)*

Gjirok 15.06.2005

**VENDIM**

**LENDA** :Mbi rikapitalizimin e fitimit neto te mbartur nga vitet e merparshme(1994-2004) per rritjen e kapitalit fillestar te shoqerise

Asamblea e ortakeve te Sh.p.k. "Argjiro- Building " ne mbledhjen e dates 15.06.2005 me unanimitet

**VENDOSI**

1. Fitimi neto i mbartur nga periudha 1994-2004 qe simpas bilancit te vitit 2004 rezulton **4.531.240** (kater milion e peseqind e tridhjet e nje mije e dyqin e dyzet ) leke te mos u shperndahet ortakeve .
2. Ky fitim te perdoret per rritjen e kapitalit fillestar te shoqerise me qellim qe ne te ardhmen te perdoret per blerje makinerish e pajisjesh per zgjerim te aktivitetit prodhues e ndertues te shoqerise
3. Kapitali i ri fillestar te pasqyrohet ne vendimin e ri te Gjykates se Tiranes per shoqerine.
4. Cabtohet ekspert kontabel i autorizuar zyj stoli date .

Vasillaq NASTO



ORTAKET

Vladimir NASTO



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE  
GJIROKASTER  
NR. 252 REP.

**V E R T E T I M**

Ne Gjirokaster, sot me daten 16.06.2005 gjashtembedhjte qershor dymije e pese, para meje noteres Greta R. Kallojeri u paraqiten personalisht VASILLAQ NASTO, biri Thomait, banues ne Gjirokaster, qe mban leter njoftiminh UG Nr 285766 dhe VLADIMIR NASTO,, biri Thomait, banues ne Gjirokaster, qe mban leter njoftimin NF Nr 209871 , me zotesi te plote juridike per te vepruar, te cilet kane nenshkruar vendimin e asamblese se jashtezakonshme jashte kesaj zyre dhe une bej legalizimin sipas ligjit

SE

00

DHOMA E NOTEREVE  
GJIROKASTER  
NOT. GRETA KALLOJERI  


K È R K E S È



5143

VASILLAQ NASTO, i biri Thomait, lindur më 1950, banues në Gjirokastrë.  
VLADIMIR NASTO, i biri Thomait, lindur më 1964 " "  
ZAIM DADAJ, i biri Mahmutit, lindur më 1961, banues Gjirokastrë.

OBJEKTI

Kërkojmë rregjistrimin e shoqëriqë si person juridik.

GJYKATËS SË RRETHIT

T I R A N È

Mbi kërkesën të kërkojë të rregjistrojmë shoqërinë si person juridik të emërtuar " ARGJIRO BUIDING" sh.p.k. të themeluar në ortakëri nga ne të tre në aktivitetin tregtar në ndërtim civil industrial, turistike, bujqësore, etj. restaurime të objekteve të ndryshme; prodhimin e materjaleve ndërtimore, tregtimin e materjaleve ndërtimore. Kjo shoqëri ka selinë e saj në Gjirokastrë, lagja " Puntori " pl. 1 a p.15, me një aktivitet mbi dhjetë vjet, me një kapital 100.000 lek në natyrë, me Administrator Vasillaq Nasto.

Sa sipër kërkojmë rregjistrimin e shoqërisë .

KËRKUSIT  
VASILLAQ NASTO  
VLADIMIR NASTO  
ZAIM DADAJ

*[Handwritten signatures]*

*Go nënshkruhet  
28.06.94  
[Signature]*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT TIRANË

NOTERIA

Nr. 10976 Rep.

Nr.

V È R T E T I M

Sot, më datë 21.6.1994 përpara meje Neteres u paraqitën personalisht, Vasillaq Nasto, Vladimir Nasto dhe Zaim Dadaj, banues në Gjirokastrë me zotësi të plotë juridike të njohur prej meje në bazë të letër njoftimit që më paraqitën të cilët më deklaruan se sa sipër është shkruajtur me vullnetin e tyre të lirë. Nënshkrimi i tyre u vërtetua dhe nga unë Noterja.





MINISTRIA E NDERTIMIT ,STREHIMIT

N.0657

E RREGULLIMIT TE TERITORIT

KOMISIONI I DHENIES SE LICENSAVE PROFESIONALE

L I C E N S E

Ndermarrja private me emertimin "Argjiro Bulding"

me adrese Gjirokaster

me drejtues teknik z.Vasillaq Nasto.

me perfaqesues ligjor z.Vasillaq Nasto.

eshte regjistruar ne regjistrin themeltar te ndermarrjeve per projektim dhe zbatim nga data 25.11.1993 per kategorite e specifikuara te punimeve:

Per projektim

Kat2 - ndertime civile ,(deri dy kate)

Kat9/a - ujsjellsa,kanalizime.

Per zbatim:

Kat1 - punime dheu,murature,betoni,b/arme te zakonshme, punime shembjesh.

Kat2 - ndertime civile,industriale,turistike,bujqesore, etj dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to.

Kat3 - punime restaurimi.

Kat6 - punime te shtresave te rrugeve.



Kat11 - galeri tunele.

Sekretare e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Elsa Jucja

Arben Demiri



Fulla e Takses

16 2424

Data 10.12.1993



D E K L A R A T Ë

---

Unë, i nënshkruari Ylli Canaj, i biri Shyqyriut, lindur më 1961, banues në Tiranë në Rrg. " Kongresi i L shajes" pll. 32 ap. 11 shk. 1 , redaktoj këtë deklaratë si më poshtë vijon: -----

- I thirrur me detyrën e expertit në krijim e sipër të emërtuar " ARGJIRO BUIDING" sh.p.k. të themeluar nga ortakët Vesillaq Nasto, Vladimir Nasto dhe Zaim Dadaaj deklaroj se kapitali i kësaj shoqërie përbëhet nga një makinë prodhuese e përpunuese të materjaleve ndërtim or me vlerë 100.000lek me faturë blerje të rregullt. -----

Sa sipër u redaktua kjo deklaratë me vullnetin tim të lirë dhe nënshkruhet prej meje rregullisht përpara Neterit.

DEKLARUSI

YLLI CANAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E SRETHIT TIRANË  
NOTERIA

Nr. 10935 Rep.

Nr. kol.

V È R T E T I M

---

Set, më datë 21.6.1994 përpara meje Neteres u paraqitë personalisht Ylli Canaj, banues në Tiranë me zotësi të plotë juridike i njohur prej meje në bazë të letër njoftimit që më paraqiti i cili më deklaroi se sa sipër është shkrua jtur me vullnetin e tij të lirë. Nënshkrimi i tij u vërtetua dhe nga unë Neterja.

NOTERE







D.K

**GJYKATA:**

TIRANE

**NR. Vendimit:**

5143

**Data Vendimit:**

6/1994

**Adresa:**

GJIROKASTER

**Lloji i Biznesit**

SHPK

SHA

**Administratori:**

VASILLAR

NASTO

**Admin te tjere**

PO

Jo

**Emri i Kompanise:**

ARGJIRO-BUILDING